



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: Dhjetor 2020

Nr:

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E MODELEVE TË DOKUMENTACIONIT TË PUNËS QË DO TË PËRDORIN
KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR,
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronjat “b” dhe “n”, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VËREN

Referuar nenit 19, paragrafi 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetencë për miratimin e dokumentacionit të punës së administratës zgjedhore.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ), në përmbushje të detyrave për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në Zonën e Administrimit Zgjedhor, sipas parashikimeve të nenit 33 e vijues të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar:

1. Regjistron në:

a) librin e protokollit të mbledhjeve:

- i. informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zonë, sipas parashikimit të nenit 33 shkronja “c”;



Data: 2020

Nr.

Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021

- ii. procesverbalet e mbledhjeve të KZAZ-së, ku shënon datën orën, pjesëmarrësit, çështjet që diskutohen, propozimet, mënyrën e votimit të anëtarëve të KZAZ-së, sipas parashikimit të nenit 34 shkronja“d”;
- b) regjistrin e vendimeve, vendimet e marra nga KZAZ, sipas parashikimeve të nenit 34, shkronja “e”;
- c) procesverbalin e konstatimit, të gjitha parregullsitë gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit, dhe kutitë e materialeve të votimit, dhe të gjitha pasaktësisë e konstatuara nga KZAZ gjatë procesit të numërimit të votave, sipas parashikimeve të neneve 115, paragrafi 6, dhe 116 paragrafi 7.

2. Merr vendime për:

- a) propozon kryetarin dhe zv.kryetarin e KZAZ-së, sipas parashikimit të nenit 29 paragrafi 2;
- b) emëron anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, sipas parashikimit të nenit 33, shkronja “b”;
- c) emëron kryetarët dhe sekretarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, sipas parashikimit të nenit 36, paragrafi 3;
- ç) shkarkon nga detyra anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, me vendim, sipas parashikimeve të nenit 39, paragrafi 1;
- d) liron nga detyra anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, sipas parashikimeve të nenit 39 paragrafi 2;
- dh) cakton qendrën e votimit më të afërt ku do të votojnë anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së, të cilët pajisjen me vërtetim të posaçëm, sipas parashikimeve të nenit 58 paragrafi 2;
- e) cakton numrin e grupeve të numërimit të votave në rang ZAZ-je, sipas parashikimeve të nenit 95 paragrafi 1;
- ë) emëron, anëtarët e grupeve të numërimit të votave, sipas parashikimeve të nenit 95 paragrafi 2;
- f) njofton Policinë e Shtetit për vendosjen e rendit në vendin e numërimit të votave, në rastet e prezencës së personave të paautorizuar dhe/ose cënimit të rendit në vendin e numërimit të votave, sipas parashikimeve të nenit 121, paragrafi 2;
- g) kërkon largimin e punonjësit të Policisë së Shtetit nga vendi i numërimit të votave, sipas parashikimeve të nenit 121, paragrafi 2;
- gj) akrediton vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, sipas parashikimeve të nenit 6 paragrafi 1 dhe 6.

3. Lëshon vërtetime:

- a) me kërkesë të zgjedhësve, nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve në Zonën përkatëse të Administrimit Zgjedhor, sipas parashikimit të nenit 34 shkronja“g”;



- b) për anëtarët e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për të votuar në qendrën e votimit më të afërt, sipas parashikimit të nenit 58 paragrafi 2;

4. Dokumenton përmes procesverbaleve:

- a) marrjen në dorëzim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:
- i. të materialeve të nevojshme për punën e KZAZ-së për administrimin e zgjedhjeve;
 - ii. të materialeve zgjedhore për të gjitha qendrat e votimit të zonës së administrimit zgjedhor përkatës, sipas parashikimeve të nenit 99;
- b) shpërndarjen e materialeve zgjedhore për çdo komision qendre votimi nën juridiksionin, në funksion të administrimit të procesit të votimit në qendrën e votimit, sipas parashikimeve të nenit 100;
- c) marrjen në dorëzim nga të gjitha komisionet e qendrave të votimit nën juridiksionin të kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit, sipas parashikimeve të nenit 115;
- ç) dorëzimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të ZAZ-së, tabelave të rezultateve të qendrave të votimit, dhe të gjithë dokumentacionit të punës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, sipas parashikimeve të nenit 122.

5. Pajis Grupet e Numerimit të Votave me dokumentacion për procesin e numërimit, sipas parashikimit të neneve 116 paragrafi 4, dhe 118 paragrafi 5;

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përmbushje të kompetencës së parashikuar në nenin 19 paragrafi 1 shkronja “b” dhe “n”, për drejtimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së administratës zgjedhore, për zbatimin e detyrave të përcaktuara në ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij, përcakton modelet e dokumentacionit të punës që do të përdorin Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të ngrihen për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, dhe për kqyrjen e materialit zgjedhor të dorëzuar nga KZAZ për nevoja të hetimit administrativ në KQZ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronjat “b” e “n”, dhe në nenet vijues të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, gjatë veprimtarisë së tyre për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e



Data: 2020
Nr.

Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021

Administrimit Zgjedhor, për kryerjen e detyrave të përcaktuara në ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, do të përdorin modele të dokumentacionit bashkëlidhur, si më poshtë përcaktuar:

1.1 Për dokumentimin e mbledhjeve, dhe të veprimtarisë së KZAZ-së:

Librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së;

Regjistrin e vendimeve;

Regjistrin e korrespondencës;

Procesverbal Konstatimi;

1.2 Për vendimet e KZAZ-së:

Model KZAZ 1 “Për propozimin e kryetarit të KZAZ-së”

Model KZAZ 2 “Për propozimin e zëvendëskryetarit të KZAZ-së;

Model KZAZ 3 “Për emërimin e anëtarëve të KQV-së”

Model KZAZ 4 “Për emërimin e kryetarit, dhe sekretarit të KQV-së”

Model KZAZ 5 “Për lirimin dhe emërimin e anëtarëve të KQV-së”

Model KZAZ 6 “Për lirimin dhe emërimin e kryetarit/sekretarit të KQV-së”

Model KZAZ 7 “Për shkarkimin e anëtarit/sekretarit të KQV-së”

Model KZAZ 8 “Për caktimin e grupeve të numërimit të votave”

Model KZAZ 9 “Për emërimin e anëtarëve të grupit të numërimit të votave”

Model KZAZ 10 “Për caktimin e QV për votimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së”

Model KZAZ 11 “Për shkarkimin e personave të ngarkuar për numërimin e votave”

Model KZAZ 12 “Për njoftimin e Policisë së Shtetit për vendosjen e rendit në VNV”

Model KZAZ 13 “Për largimin e Policisë së Shtetit nga VNV”

Model KZAZ 14 “Për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore”

1.3 Për vërtetimet që lëshon KZAZ:

Model KZAZ 15 Vërtetim për zgjedhësin emri i të cilit nuk gjendet në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor;

Model KZAZ 16 Vërtetim për zgjedhësin emri i të cilit që gjendet në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor;

Model KZAZ 17 Vërtetim i posaçëm për votimin e anëtarit/sekretarit të KZAZ-së;



1.4 Për dokumentimin e marrjes në dorëzim/shpërndarjes tek KQV-të/dorëzimit të materialeve zgjedhore në KQZ:

Model KZAZ 18 “Për pajisjen e KZAZ me materiale për administrimin e zgjedhjeve”

Model KZAZ 19 “Për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për procesin e numërimit të votave”

Model KZAZ 20 “Për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për KQV-të e ZAZ-së”

Model KZAZ 21 “Për dorëzimin e fletëve të votimit për çdo Qendër Votimi të ZAZ”

Model KZAZ 22 “Për pajisjen nga KZAZ me materiale zgjedhore të KQV”

Model KZAZ 23 “Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë”

Model KZAZ 24 “Për dorëzimin në KZAZ të materialeve të votimit, kutisë së votimit me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve të votimit nga KQV”

Model KZAZ 25 “Për dorëzimin nga KZAZ në KQZ të materialeve të inventarizuara”

Model KZAZ 26 “Për dorëzimin në KQZ të tabelave të rezultateve, procesverbal konstatimi, vula e KZAZ”

Model KZAZ 27 “Për dorëzimin në KQZ nga KZAZ të vendimeve të KZAZ”

Model KZAZ 28 “Për dorëzimin nga KZAZ në KQZ të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore”

1.5 Për procesin e numërimit të votave (plotësohen nga Grupet e Numërimit të Votave):

Model GNV 1 “Për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara të QV-së”

Model GNV 2 “Për mbylljen e kutisë së materialeve zgjedhore të QV-së”

1.6 Për administrimin e fletëve të votimit:

Model Z04 Etiketë e zarfit të fletëve të votimit të kontestuara

Model Z05 Etiketë e zarfit të fletëve të votimit të pavlefshme

Model Z06 Etiketë e zarfit të fletëve të votimit të vlefshme

Model Z07 Etiketë e zarfit të fletëve të votimit të kandidatit

2. Për kqyrjen e materialit zgjedhor të dorëzuar nga KZAZ-ja në KQZ për nevoja të hetimit administrativ, përdoret:

Model KQZ 1 “Për rimbylljen e kutive të votimit dhe/ose kutive të materialeve të votimit pas hetimit administrativ në KQZ”



3. Specifikimet teknike të dokumentacionit të marrjes në dorëzim/shpërndarjes tek KQV-të/dorëzimit të materialeve zgjedhore në KQZ, dhe të zarfave ku administrohen fletët e votimit pas vlerësimit nga GNV, janë sipas lidhjes 1 bashkelidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 2020

Nr.

Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
09.12.2020

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR MIRATIMIN E MODELEVE TË DOKUMENTACIONIT TË PUNËS TË KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në bazë të kompetencës së parashikuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronjat “b” dhe “n”, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

Dokumentacioni i punës së KZAZ-së, përbëhet nga:

- Libri i Protokollit të Mbledhjeve, Rregjistri i Vendimeve, Rregjistri i Korrespondencës, Procesverbali i Konstatimit;
- Modelet e vendimeve që merren nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (katërbëdhjetë modele vendimesh);
- Modelet e vërtetimeve që lëshon KZAZ me kërkesë të zgjedhësve apo për caktimin e qendrës së votimit ku voton anëtari/sekretari i KZAZ (tre modele vërtetimesh);
- Modelet e procesverbaleve të marrjes në dorëzim nga KQZ/shpërndarjes për KQV-të dhe dorëzimit në KQZ të materialeve zgjedhore (njëmbëdhjetë modele);
- Modelet e procesverbaleve që plotësojnë grupet e numërimit të votave gjatë procesit të numërimit të votave (dy modele);
- Modelet e zarfave për administrim të fletëve të votimit (katër modele).

Në lidhjen 1 bashkëlidhur projektvendimit, paraqiten specifikimet teknike të procesverbaleve dhe të zarfave që do të përdoren nga KZAZ.

Ky dokumentacion është i plotë për dokumentimin e punës, veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, sipas përcaktimeve të nenit 33 e vijues të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm





ZGJEDHJET PËR KUVEND
TË DATËS 25 PRILL 2021

Z 07

KZAZ _____

QV nr. _____

ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT
PARAPËLQYES PËR KANDIDATIN

SEKRETARI

Numëruesi i Parë

(EMËR, MBIEMËR, FIRMË)

(EMËR, MBIEMËR, FIRMË)



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 25 PRILL 2021

Z 06

KZAZ _____

QV nr. _____

ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT
TË VLEFSHME

SEKRETARI

Numëruesi i Parë

(EMËR, MBIEMËR, FIRMË)

(EMËR, MBIEMËR, FIRMË)



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 25 PRILL 2021

Z 05

KZAZ _____

QV nr. _____

ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT
TË PAVLEFSHME

SEKRETARI

Numëruesi i Parë

(EMËR, MBIEMËR, FIRMË)

(EMËR, MBIEMËR, FIRMË)



ZGJEDHJET PËR KUVEND
TË DATËS 25 PRILL 2021

Z 04

KZAZ _____

QV nr. _____

ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT
TË KONTESTUARA

SEKRETARI

Numëruesi i Parë

(EMËR, MBIEMËR, FIRMË)

(EMËR, MBIEMËR, FIRMË)



**KOMISIONI QENDROR
I ZGJEDHJEVE**

KZAZ nr.	
Qarku	

REGJISTËR I VENDIMEVE

ZGJEDHJE PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË
25 PRILL 2021



**KOMISIONI QENDROR
I ZGJEDHJEVE**

KZAZ nr.	
Qarku	

REGJISTËR I KORRESPONDENCËS

ZGJEDHJE PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË
25 PRILL 2021



**KOMISIONI QENDROR
I ZGJEDHJEVE**

KZAZ nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL KONSTATIMI

**ZGJEDHJE PËR
KUVENDIN E
SHQIPËRISË
25 PRILL 2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL
Për dorëzimin nga KZAZ në KQZ të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore
Datë:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, në zbatim të nenit 122 paragrafi 4, të ligjit 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, dorëzon:

Nr	Nr i QV –së		Numrat e kodeve të vulave	Nr	Nr i QV –së		Numrat e kodeve të vulave
	KV	KMZ			KV	KMZ	
1.			1)	6.			1)
			2)				2)
			3)				3)
			4)				4)
			5)				5)
2.			1)	7.			1)
			2)				2)
			3)				3)
			4)				4)
			5)				5)
3.			1)	8.			1)
			2)				2)
			3)				3)
			4)				4)
			5)				5)
4.			1)	9.			1)
			2)				2)
			3)				3)
			4)				4)
			5)				5)
5.			1)	10.			1)
			2)				2)
			3)				3)
			4)				4)
			5)				5)

KZAZ:

KQZ:

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

(emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

VULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL Për dorëzimin në KQZ nga KZAZ të vendimeve të KZAZ
Datë:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, në zbatim të nenit 178, paragrafët 3 dhe 4, të ligjit 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, dorëzon:

Dokumentet origjinale që dorëzon KZAZ-ja	Sasia (fletë)	Shënime
Lista e emrave dhe adresave të anëtarëve të KZAZ-së		
Vendimet e emërimit të anëtarëve të KQV-ve dhe dokumentacioni përkatës		
Vendimet e emërimit të anëtarëve të GNV-ve dhe dokumentacioni përkatës		
Vendime për lirimin e anëtarëve të KQV		
Vendime për shkarkimin e anëtarëve të KQV/GNV		
Dokumentacioni për njoftimin e Policisë së Shtetit		
Lista e zgjedhësve të zonës zgjedhore		
Deklarata e shpenzimeve të bera për administrimin e zgjedhjeve		

KZAZ:

KQZ:

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

(emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

VULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL Për dorëzimin në KQZ të tabelave të rezultateve, procesverbal konstatimi, vula e KZAZ
Datë:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, në zbatim të nenit 122, paragrafët 3 dhe 4, të ligjit 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, dorëzon:

Tabela përmbledhëse e rezultateve të zgjedhjeve në ZAZ	Nr	Emërtimi	Copë
	1	Libër Protokolli	
(nr faqesh me shifër)	2	Procesverbal Konstatimi	
	3	Vula e KZAZ-së	
	4	Regjistri i Vendimeve KZAZ-së	
(nr faqesh me fjalë)	5	Regjistri i korrespondencës	

Nr	Nr. i QV	Tabela Origjinale e Rezultatit të QV-së	Shënime
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			

KZAZ:

KQZ:

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

(emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

VULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL
Për dorëzimin nga KZAZ në KQZ të materialeve të inventarizuara
Datë:

1. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, në zbatim të nenit 122 paragrafi 4, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, dorëzon në KQZ:

Nr	Materiale për administrimin e zgjedhjeve	Njësia	Sasia
1	Aparat Telefon	copë	
2	Makinë llogaritse	copë	
3	Pinca metalike	copë	
4	Element ndarës për organizimin e VNV-së	copë	
5	Bazament për identifikimin e GN-së	copë	

2. Në rast se nuk do të dorëzohen të gjitha materialet e inventarizuara, vlera financiare e tyre do të mbahet nga pagesa e anëtarëve të KZAZ-së.
3. Në raste të dëmtimit, thyerjes, apo humbjes së materialeve jo për faj të KZAZ, dëmi ekonomik duhet të vërtetohet me anë të një proces-verbali të vulosur dhe të firmosur nga Kryetari, zv/Kryetari dhe Sekretari i KZAZ-së. Mos dorëzimi i procesverbalit të vulosur dhe të firmosur nga Kryetari, zv/Kryetari dhe Sekretari i KZAZ-së, ngarkon KZAZ me përgjegjësi financiare.
4. Ky procesverbal mbahet në 4 (katër) kopje. Kopja origjinale (faqja e parë) e këtij proces-verbali do të dorëzohet në Zyrën e Financës, pranë KQZ-së, e cila do të bëjë edhe verifikimin e vlerës së materialeve të dorëzuara në KQZ pas përfundimit të procesit zgjedhor.

KZAZ:

KQZ:

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

_____ (emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

_____ (emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

VULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
KQV nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL Për dorëzimin nga KQV në KZAZ të materialeve të votimit	
Datë: <i>E marrjes në dorëzim</i>	Ora: <i>E marrjes në dorëzim</i>

Ky procesverbal mbahet në 4 (katër) kopje. KZAZ është e detyruar që të dorëzojë fagen e parë origjinale në KQZ. Kopjen e 2-të e mban KZAZ-ja, kopja e 3-të i jepet KQV-së dhe një kopje e merr punonjësi i Policisë së Shtetit.

1. Komisioni i Qendrës së Votimit, në zbatim të nenit 115 paragrafët 2,3,4,7 dhe 8, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, dorëzon:

1	Kuti Votimi me nr. të vulave të sigurisë: kutia e votimit duhet të jetë e vulosur me 5 vula (kode)				
	1.1 Kjo kuti votimi është:		1.2. Nëse kutia e votimit është ë parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara:		
	a. e rregullt <input type="checkbox"/>	b. e parregullt <input type="checkbox"/>	_____		
	KUTIA E VOTIMIT ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË:				
1)	2)	3)	4)	5)	
2	Kuti e Materialeve Zgjedhore me nr. të vulave të sigurisë: (duhet të jetë e vulosur me 4 vula/kode)				
	2.1 kutia e materialeve zgjedhore është:		2.2. Nëse kutia e MZ është ë parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara:		
	a. e rregullt <input type="checkbox"/>	b. e parregullt <input type="checkbox"/>	_____		
	KUTIA E MATERIALEVE ZGJEDHORE ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË:				
1)	2)	3)	4)	5)	
3	VULA REZERVË TË PAPËRDORURA:				
	1)	2)	3)		

Punonjësi i Policisë se Shtetit:	Dorëzuesi nga: KQV nr. _____	Marrësi në dorëzim nga Anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim:
_____ (emër, mbiemër, firmë)	Kryetar: _____ (emër, mbiemër, firmë)	Anëtar: _____ (emër, mbiemër, firmë)
	Sekretar: _____ (emër, mbiemër, firmë)	Anëtar: _____ (emër, mbiemër, firmë)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
KQV nr:	

PROCESVERBAL Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë	
Datë:	

1. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr____, në bazë të nenit 100, paragrafët 1, shkronja “d”, dhe 4, të ligjit 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i dorëzon vula me kode të sigurisë KQV-së nr. _____.

Nr	Kodi i vulës së sigurisë	Nr	Kodi i vulës së sigurisë rezervë
1		10	
2		11	
3		12	
4			
5			
6			
7			
8			
9			

2. Ky procesverbal mbahet në 3 (tre) kopje. Një nga kopjet e procesverbalit dorëzohet nga KZAZ në KQZ.

Dorëzuesi nga: KZAZ _____

Marrësi në dorëzim nga KQV nr. _____ :

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

VULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL Për pajisjen nga KZAZ me materiale zgjedhore të KQV
Datë:

1. Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor nr.____, në zbatim të nenit 100, paragrafët 1, 2, dhe 3, të ligjit 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, i dorëzon KQV nr_____:

Nr	Materiale për administrimin e zgjedhjeve	Njësia	Sasia
1	Fletë Votimi	Fletë/bllok	
2	Proçes-verbali i vulosjes së kutive të votimit	bllok	
3	Procesverbali i mbylljes së votimit	bllok	
4	Kuti Votimi	copë	
5	Kuti e Materialeve Zgjedhore	copë	
6	Vula e KQV-së	copë	
7	Vula për kryetarin e KQV-së	copë	
8	Bojë matrikuluese	copë	
9	Set i zarfave të sigurisë (Z.01, Z.02, Z.03)	copë	
10	Dhoma të fshehta për personat me aftësi të kufizuar	copë	
11	Dhoma të fshehta	copë	
12	Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së	copë	
13	Rregjistër i Posaçëm i Zgjedhësve	copë	
14	Tabela identifikimi + posterat edukues	copë	
15	Paketë e kancelerie	copë	

2. Ky procesverbal mbahet në 4 (katër) kopje. Secila kopje firmoset nga Kryetari, Zv.Kryetari, Sekretari i KZAZ dhe Kryetari, Sekretari i KQV.

Komisioni Qendrës Votimit nr.....:

KZAZ:

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

VULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL Për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për KQV-të e ZAZ-së
Datë:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 99, paragrafët 1, 2, 3, të ligjit 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, dorëzon:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Procesverbali i vulosjes së kutive të votimit	bllok	
2	Procesverbali i mbylljes së votimit	bllok	
3	Vulat e KQV-ve	copë	
4	Vulat për kryetarët e KQV-ve	copë	
5	Kuti të Materialeve Zgjedhore	copë	
6	Kuti Votimi	copë	
7	Vula me kode sigurie	copë	
8	Bojë matrikuluese	set	
9	Set i zarfave të sigurisë (Z.01, Z.02, Z.03)	set	
10	Dhoma të fshehtësisë	copë	
11	Dhoma të fshehtësisë për personat me aftësi të kufizuar	copë	
12	Paketë kancelerie	copë	

2. Ky procesverbal mbahet në 4 (katër) kopje. Secila kopje firmoset nga Kryetari, Zv.Kryetari dhe Sekretari i KZAZ-së dhe punonjësi i KQZ-së që kryen dorëzimin.

Për KQZ:

KZAZ:

1. _____
(emër mbiemër firmë)

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

2. _____
(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL Për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për procesin e numërimit të votave
Datë:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 99, paragrafët 1, shkronja “d”, “dh”, “e”, “ë”, dhe 2 shkronja “b”, të ligjit 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, dorëzon:

Nr	Materiale për administrimin e zgjedhjeve	Njësia	Sasia
1	Tabela e Rezultateve për QV-të (plotësohet nga GNV)	copë	
2	Tabela përmbledhëse e Rezultateve (plotësohet nga KZAZ)	copë	
3	Set i zarfave (Z 04, Z 05, Z 06, Z 07)	Set	
4	Bojë matrikuluese rezervë për KQV-të	copë	
5	Vula me kode sigurie për GNV-të	copë	
6	Vula me kode sigurie rezervë për GNV-të	copë	
	Të inventarizuara	Njësia	Sasia
7	Pinca për këputjen e vulave me kode të sigurisë	copë	
8	Makinë llogaritëse	copë	
9	Shirit ndarës për VNV-në	m/linear	
10	Element ndarës për organizimin e VNV-së	copë	
11	Bazament për identifikimin e GN-së	copë	

2. Materialet e inventarizuara kthehen në KQZ. Moskthimi i tyre ngarkon KZAZ-në me përgjegjësi financiare.
3. Ky procesverbal mbahet në 4 (katër) kopje. Secila kopje firmoset nga Kryetari, Zv.Kryetari dhe Sekretari i KZAZ-së dhe punonjësi i KQZ-së që kryen dorëzimin.

Për KQZ:

KZAZ:

1. _____
(emër mbiemër firmë)

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

1. _____
(emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

VULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

PROCESVERBAL Për pajisjen e KZAZ me materiale për administrimin e zgjedhjeve
Datë:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 99 paragrafi 4, të ligjit 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, i dorëzon KZAZ-së nr _____:

Nr	Materiale për administrimin e zgjedhjeve	Njësia	Sasia
1	Vula e KZAZ-së	copë	
2	Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së	copë	
3	Rregjistër i Vendimeve të KZAZ-së	copë	
4	Rregjistër i Korrespondencës të KZAZ-së	copë	
5	Procesverbal Konstatimi	copë	
6	Materiale kancelarie	set	
7	Set dokumentacioni zgjedhor	set	
	Të inventarizuara	Njësia	Sasia
8	Makinë llogaritse	copë	
9	Aparat telefoni	copë	

2. Materialet e inventarizuara kthehen në KQZ. Moskthimi i tyre ngarkon KZAZ me përgjegjësi financiare.
3. Ky procesverbal mbahet në 4 kopje. Secila kopje firmoset nga Kryetari, Zv.Kryetari dhe Sekretari i KZAZ, dhe punonjësi i KQZ-së që kryen dorëzimin.

Për KQZ:	KZAZ:
-----------------	--------------

1. _____
(emër mbiemër firmë)

Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

2. _____
(emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër mbiemër firmë)

Sekretar: _____
(emër mbiemër firmë)

VULA





KOMISIONI I ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

KZAZ nr.	
Qarku	

VËRTETIM I POSAÇËM

Vërtetohet se z/znj _____, është anëtar/e i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, nr _____.

Bazuar në nenin 58, paragrafi 2, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimin e KZAZ-së nr. _____ datë _____ 2021 “Për caktimin e qendrës së votimit ku do të votojnë anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së”

z/znj. _____ do të votojë në qendrën e votimit nr. _____,

SEKRETARI I KZAZ-SË

(emër, mbiemër, firma)

VULA

Miratuar me Vendimin nr.... Date....12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Model KZAZ 17



KOMISIONI I ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

KZAZ nr.	
Qarku	

VËRTETIM I POSAÇËM

Vërtetohet se z/znj _____, është anëtar/e i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, nr _____.

Bazuar në nenin 58, paragrafi 2, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimin e KZAZ-së nr. _____ datë _____ 2021 “Për caktimin e qendrës së votimit ku do të votojnë anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së”

z/znj. _____ do të votojë në qendrën e votimit nr. _____,

SEKRETARI I KZAZ-SË

(emër, mbiemër, firma)

VULA

Miratuar me Vendimin nr.... Date....12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Model KZAZ 17



KOMISIONI I ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

KZAZ nr.	
Qarku	

VËRTETIM

